



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0630-A0001

Në çështjen juridike të:

‘D C’ nga Shkupi, i përfaqësuar nga avokati V P -Gjilan.

Paditësi/ankuesi

Kundër:

Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte-Prishtinë.

E paditura

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-14-5905, të datës 04 tetor 2022., pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

Ankesa e paditësit e datës 16 nëntor 2022, e parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-14-5905 të datës 04 tetor 2022, konsiderohet e tërhequr.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 19 gusht 2014, paditësi dorëzoi në DHPGJSK një ankesë/padi kundër Vendimit të Autoritetit të Likudimit të N.SH “Integj”, e përfaqësuar nga AKP (AL i AKP-së) GJI085-1568, të datës 16 korrik 2014. Me këtë vendim ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit për kompensimin në lidhje me furnizimin, në shumën 366.000.00 euro.

Paditësi ka theksuar se me të paditurin Kombinati i Tekstilit në Gjilan, ka pasur bashkëpunim të rregullt afarist dhe të njëjtën e ka funizuar me lëndë të parë dhe repro material për nevoja të prodhimit.

Në mbështetje të këtyre pretendimeve, paditësi ka bashkangjitur, faturën nr.52016, të datës 27 gusht 1997, sipas të cilës vërtetohet malli i dorëzuar dhe qmimi, përmes pratnerit të tregtis së jashtme “Jugoexport” në Beograd, si për sasi prej 30.000 metra me çmim prej 6 DM dhe faturën nr.52012, datë 14 prill 1997, në shumën prej 160.000.00 DM me dokumentacionin përcjellës e doganor.

Paditësi i ishte drejtuar Ambasadës së Rebulikës së Francës në Shkup me shkresën e datës 03 korrik 2000, UNMIK-ut, Shefit të misionit në Shkup të datës 30 nëntor 2004, Odës Ekonomike me datë 22 nëntor 2004, Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rebulikës së Maqedonisë më 22 janar 2004 dhe kerkesë AKM-së Gjilan nr. 535/07 të datës 06 shkurt 2007. Paditësi kishte theksuar se në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për parashkrim të kerkesës, për tri vite siq ishte arsyetuar në Vendimin e Ankimuar të Autoritetit të Likudimit.

Më 14 qershor 2021, e paditura parashtroi mbrojtjen ndaj kësaj ankese dhe thekson se AL i AKP-së ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore materiale. AKP-ja pohoi se përveç që ankesa është e dorëzuar me vonesë, pretendimet e ankuesit edhe janë parashkruar, pasi që i njëjti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik kundër NSH gjatë periudhës qershor 2008-qershor 2011.

Më 04 tetor 2022, Shkalla e parë DHPGJSK-së kishte marrë aktgjykimin C-IV-14-5905 me të cilin e kishte refuzuar kërkesën e paditësit duke e vërtetuar vendimin e kundërshtuar të AL të AKP-së si të drejtë dhe të bazuar në ligj, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar Sipas arsyetimit të dhënë, kjo kërkesë ka mundur që të parashtrohet më së largu në vitin 2000 në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë.

Më 16 nëntor 2022, paditësi parashtroi në DHPGJSK një ankesë kundër këtij aktgjykimi për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet në tërësi ky aktgjykim dhe lënda të kthete në rigjykim. Ankuesi pretendon se kërkesa nuk është parashkruar dhe se ka ofruar dëshmi të bollshme që mbështesin kërkesën e tij.

Më 02 dhjetor 2022 Zyra për financa e DHPGJSK-së përes vrejtjes gjyqësore ka kërkuar që të paguhet taksa gjyqësore me mundësi që të parashtroj kërkesë për tu liruar nga kjo pagesë nëse nuk ka mundësi financiare. Nëse nuk paguhet kjo taksë, ankesa do të konsiderohet e tërhequr. Nga fletëkthesa shihet se përfaqësuesi i paditësit këtë vërejtje e ka pranuar më 05 dhjetor 2022, por nuk e ka paguar taksën e kërkuar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa konsiderohet e tërhequr.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Shkalla e parë e kishte refuzuar ankesën/padinë e paditësit të parashtruar kundër vendimit të AL të AKP-së, me arsyetimin se kërkesa është e parashkruar.

Ankuesi kishte parashtruar ankesë kundër aktgjyqimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së me pretendimin se kërkesa nuk është parashkruar.

Zyra e regjistrimit të DHPGJSK-së kishte kërkuar nga ankuesi që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore në emër të ankesës para Kolegjit të Apelit, me vrejten se nëse nuk paguhet taksa apo nëse nuk bënë kërkesë për lirim nga kjo pagesë, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Sipas nenit 253.4 të ligjit të Procedurës kontestimore (LPK): "Paditësi ka pë detyrë që padisë t'ia bashkangjisë vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar".

Më tutje, neni 253.5 thotë që: "Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, dhe nuk ekzistojnë kondiktat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr".

Në bazë të nenit 3.1 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017(UA) të këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJL), përcaktimi i taksës gjyqësore për t'u paguar në kohën kur është paraqitur/paarshtuar parashtrësja, është i bazuar në vlerën e kontestit, respektivisht në natyrën e parashtrësës.

Neni 2.4 i UA-së e përcakton se shprehja "Parashtrësë", do të thotë padi, kundërpadi, ankesë, kundërshtim, kërkesë, revizion, propozim për ekzekutim.

Udhëzimi i KGJK-së nr.01/2017 i aplikueshëm që nga data 15/03/2017 për unifikimin e Taksave Gjyqësore të DHPGJSK-së përcakton se ankuesi duhet të paguajë shumën fikse për parshtrimin e ankesës.

Pasi që ankuesi nuk e ka paguar taksën gjyqësore siç është kërkuar nga ai me njoftimin (vëretjen) e datës 02 dhjetor 2022, që ishte pranuar nga përfaqesuesi paditësit/ankuesit më 05 dhjetor 2022, dhe nuk e ka paguar taksën gjyqësore si dhe nuk ka paraqitur kërkesë për lirimin nga taksa gjyqësore, Kolegji i Apelit konsideron se ankesa është tërhequr.

Nga ajo që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJSK-së më 14 dhjetor 2023.

Mr.sc Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues _____